



# 2014

## RAPORT- TM<sub>3</sub> -2014



K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A


Rr. Wesley Clark p.n. Prizren 20000

[www.hidroregjioni-jugor.com](http://www.hidroregjioni-jugor.com)

<b>PËRMBAJTJA</b>	<b>2</b>
<b>Zonat e përgjegjësisë së K.R.U. „HIDROREGJIONI JUGOR”</b>	<b>4</b>
<b>I. RAPORTI I SHËRBIMIT TEKNIK</b>	<b>5</b>
1.1.1 Aktivitetet – Korrik-Shtator 2014	5
1.1.2 Mirëmbajtja e rrjetit- sanimi I defekteve	8
1.1.3 Zyra për planifikim dhe zhvillim	8
1.1.4 Servisimi I ujëmatësave	10
1.1.5 Analizat Fiziko-Kimike dhe Bakteriologjike	11
1.2 Raport I performances operative TM3-2014	14
1.2.1 Raport I performances operative TM3-2014- NJ.P.-Prizren	14
1.2.2 Raport I performances operative TM3-2014- NJ.P.-Suharekë	15
1.2.3 Raport I performances operative TM3-2014- NJ.P.-Dragash	17
1.2.4 Raport I performances operative TM3-2014- NJ.P.-Malishevë	18
1.2.5 Raport I performances operative TM3-2014- Hidroregjioni Jugor	19
<b>II. RAPORT I SHËRBIMIT FINANCIAR</b>	<b>21</b>
2.1 <b>Raport I Sherbimit Rajonal per konsumatorë</b>	<b>21</b>
2.1.1 Aktivitetet nga Shërbimi Rajonal Për Konsumatorë	21
2.1.2 Aktivitetet e shërbimit për te kontrolles	22
2.1.3 Aktivitetet e shërbimit te ankesave	22
2.2 Raport I performances financiare TM3-2014	23
2.2.1 Raport I performances financiare TM3-2014- NJ.P - Prizren	23
2.3.1 Raport I performances financiare TM3-2014- NJ.P - Suharekë	25
2.4.1 Raport I performances financiare TM3-2014- NJ.P - Dragash	28
2.5.1 Raport I performances financiare TM3-2014- NJ.P - Malishevë	30
2.6.1 Raport I performances financiare TM3-2014- Hidroregjioni Jugor	32
2.2 <b>Aktivitetet nga Sherbimi Financiar</b>	<b>32</b>
2.2.1 <b>Aktivitetet kryesore</b>	<b>32</b>
2.2.2 Arsyesheria e shpenzimeve	33
2.2.3 Masat e realizuara	33
2.2.4 Masat e propozuara per permiresimin e performances	33
2.3 <b>Aktivitet nga Sherbimi per Konsumatorë</b>	<b>34</b>
2.3.1 Aktivitetet kryesore	34
2.3.2 Raport i ekipes se kontrolles- TM2	35

2.3.3	Raport i ekipes se kontrolles- TM3	35
2.3.4	Problemet qe kane ndikuar ne performance	36
2.3.5	Masat e realizuara	36
2.3.6	Masat e propozuara per permiresimin e performances	36
2.4	<b>Raport i Mediave – TM3 2014</b>	37
<b>III. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV</b>		
3.1	Aktivitetet – Korrik-Shtator 2014	40
3.2	Aktivitetet e zyres ligjore	42
3.3	Aktivitetet e zyres se Teknologjise Informative	45
<b>VI. RAPORT I AKTIVITETEVE TË PROKURIMIT</b>		
<b>VII. RAPORT I AUDITORIT TË MBRENDSHËM</b>		
	<b>ORGANOGRAMI</b>	51

## ZONAT E PËRGJEGJËSISË SË K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A



## I. RAPORT I SHËRBIMIT TEKNIK

### 1.1.1 Aktivitetet - Korrik - Shtator – 2014

Edhe pse prurjet e ujit në burimet e vjetra me gravitet kanë filluar te kete rritje nga te reshurat, por kedhe shtim të kapacitetve të reja të ujit permes shpimeve te pueseve, kemi arritur të kemi gjendje stabile të furnizimit me ujë për të gjithë qytetin e Prizrenit.

Kompania është angazhuar dhe ja ka arritur që në TM-3 te vitit 2014 të furnizojë konsumatorët me ujë të pijes 24 orë në përjashtim të zonave të larta të cilat furnizohen me sistem të pompimit ku dhe kemi reduktime brenda ditës (Kryesisht Laxha Dardania).

Në Njësitë tjera si në Malishevë, Suharekë dhe Dragash nuk ka pasë probleme me furnizim më ujë të pijes dhe duke u bazuar në raportet e Njesive Operuese kemi patur furnizim të rregullt me ujë të pijes.

\*Aktivitetet e shërbimit Teknik ne nivel regjional kan qene te parreshtura dhe jane orientuar ne mundesine e furnizimit sa me te rregullt me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët që kjo kompani i mbulon, si dhe në aktivitetet teknike për zvogëlimin e humbjeve si atyre teknike poashtu dhe atyre administrative respektivisht zvogëlimin e vlerave të UPF-së.

\*Në njesinë punuse të Prizrenit gjatë TM-3 ka pasur aktivitete në nderhyrjet në rrjetin e ujësjes dhe të kanalizimit: defekte në rrjetin sekondar dhe primar, pastrimi dhe fryrje te rrjetit me kompresor, kontrollimi dhe pastrimin e pusetave, kontrollime dhe pastrime te kanalizimit, riparime të rrugëve etj.

\*Në TM-3 është bërë perurimi i rrjetit të ri në lagjen e Dardanisë për furnizim me ujë për shkollen e Kompetencës dhe për nje pjesë të lagjës së lartë të Dardanisë, investim i realizuar nga bashkëfinancusit Kuvendi Komunal në Prizren dhe Hidroregjioni Jugor në Prizren.

\*Sa i perket projektit per Grumbullimin dhe trajtimin e ujerave te zeza per qytetin e Prizrenit jemi ne fazen fillestare te implementimit te projektit. Faza e pare e projektit eshte pothuajse ne fazen perfundimtare te fillimit te punimeve per momentin KfW e ka dhene No Objection (Pa kundersizim) per kompanine fituese dhe me miratimin e KfW-se dhe te HRJ-se eshte percaktuar kompania fituese PASSAVANTE nga Gjermania ne bashkpunim me kompanine vendore KWE nga Prishtina. Nga KfW jemi njoftuar se per te filluar me negociimin e kontrates me kompanine fituese duhet qe te plotesohen kriteret e marrevshjes speciale, prandaj dhe ne jemi te obliguar qe ta njoftojme KfW-ne per Statusin e kesaj marrevshje. (Per me gjeresisht raportin Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).

\*Sa i perket fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me ndertimin e ITUZ-se, momentalisht ofertat i kan dorezuar vetem 3 aplikant dhe ende jemi ne fazen e evaluimit per kompanine fituese e cila ka per detyre qe te beje edhe dixajnin edhe implementimin e projektit. Diku ka data 28.08.2014 parashihet qe te perfundoj evaluimi dhe te percaktohet kompania fituese (Per me gjeresisht raportin Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi )

\*Sa i perket pjeses se dyte te fazes se dyte te projektit te ujerave te Zeza qe ka te beje me Masat Shoqeruese eshte percaktuar Agenti i Tenderit nga ana e KfW-se dhe ne jepi ne korespondence te rregullt me te njejtin, deri me tani eshte shpallur tenderi per kete projekt dhe deri me tani jane dorezuar ofertat. Agenti i Tenderit se bashku me komitetin e projektit nga KRU“HRJ“ ka bere evalumin e ofarteve ne fazen parakualifikuese jane percaktuar 5 kompani ne kete faze KfW ka dhene miratimin per 5 kompanite qe e kan kaluar kete rund dhe i ka njoftu kompanite qe jane kualifikuar, ne te ardhmen e afert pritet pjesemarrja e ketyre 5 kompanive per te dorezuar ofertat teknime dhe financiare me crast pas ketije evaloimi do te percaktohet edhe kompania fityese. Per me gjeresisht raporton Kryetari i Komitetit te Projektit Lulzim Paçarizi dhe e posedojme raportin periodok ne te cilin jane pershkruar te gjitha aktivitetet ne lidhje me kete projekt).

Sa i perket Statusit te marrevshjes se vecant te nenshkruar nga MMPH, KfW , Komuna e Prizrenit dhe HRJ, urgjentisht kerkohet nga KfW qe te dihet se deri ku ka arritur zbatimi i kesaj marrevshje, ne theks te vecant i eshte kushtuar kujdes procesit te shpronesimit, ku pas takimit me drejtorin e sherbimeve Publike, jemi njoftuar se Kryetari i komunes e ka nenshkruar vendimin perfundimtar per te shpronesuarit si dhe eshte shpallur ne gazeten zyrtare, dhe pas afatit prej 30 diteve nga shpallja per shkak te ndonje ankese te mundshme nga pronaret do te filloj kompenzimi. Ne kerkesat e marrevshejs se vecant eshte cekur se gje punimeve dhe para se te perfundojne punimet duhet qe prona e lokacionit te ITUZ-se te kaloje ne prone te HRJ-se. (Per me gjeresisht raporton Kryetari i komitetit te projektit Lulzim Pacarizi).

\*Kohë më parë ka filluar projekti i financuar nga komuna e Prizrenit „Sheshi i Lidhjes“ projekt ky i cili parasheh vendosjen e nje gypi transportues te ujit Ø 400mm dhe Ø 125mm si dhe projektin e ujerave fekale sipas projektit te perpiluar nga zyra e konsulences, punimet janë në perfundim. Inxhinieret e konsulences dhe kompanise kane dale disa here ne mbikqyrje te punimeve, me crast dhe kemi konstatuar se punimet jane realizuar sipas paramases se dhene nga konsulenca. Ne banesen afer zyreve ge Partise Turke eshte raportuar nje ankese nga banoret ku eshte konstatuar interferenca e ujerave te zeza ne bodrumin e kesaj banese, inxhinieret se bashku me operativen kan dake ne vendin e ngajrjes per ende nuk kan mundur te konstatojne infiltrimin e ujerave te zeza se nga ka munde te infiltrohet, Operativa ka dale ne vendngjarje dhe permes pompes ka provuar te konstatoje infiltrimin por ende nuk eshte konstatuar, eshte njoftuar kompania pune kryese dhe komuna e prizrenit permes nje shkrese elektronike nga menaxheri Teknik se ne rast te konstatimit te mundshem do te pergjigjen konform konstatimit.

Projekti pothuajse ka perfunduar dhe kompania e kontraktuar nga Komuna e Prizrenit sa i perket kolektorit dhe gypave te ujit e ka kusht qe te behet incizimi me CCTV i komplet kolektorit te cilin e ka vendos kjo kompani, perndryshe nuk munde te pranohet teknikisht as nga HRJ e as nga konsulenca e projektit te Ujerave te Zeza.

(Për me tepër raporton Lumni Sallahu Udheheqes per Planifikim dhe Zhvillim).

\*Per projektin e radhes me KfW-ne Eficienca ne Energjine elektrike raporton udheheqesi i projektit Aranit Ukimeri.

\*Takime te vazhdueshme me CDI-ne per projektet qe do te finanohen nga qeveria Zviceriane dhe R. E Kosoves, ne kete takim eshte diskutuar lista e projekteve per te gjitha komunat ku operon HRJ, me crast dhe eshte bere ndarja e projekteve per rehabilitimin e sistemeve ekzistuese dhe ndertimi i sistemeve te reja te ujesjellesit, ne theks te vecant ne fazen e pare do te investohen vetem ato fshatra te cilat nuk jane nen menaxhimin e HRJ-ne, per me gjeresisht ekziston raporti nga kryetari i grupit punues z. Zenel Zenelaj.

\*Vizite ne teren neper punishtet ku jane duke u zhvilluar punime me çrast dhe eshte bere inspektimi i punimeve nga inxhinieret e kompanise. Momentalisht jemi duke i zhvilluar projektet e investuara nga MZHE, dhe kemi raportuar konform kerkesave te MZHE-se.

\*Ka perfunduar edhe pjesa e dyte e projektit te investuar nga MZHE Hapja e puseve te livadhet, me ç`rast dhe eshte dorezuar komplet dokumentacioni ne MZHE.

\*Vizita ne teren ne punishtet ku jane duke u realizuar projektet, me crast kemi konsatuar se mbarevajtja e projekteve eshte duke shkuar sipas dinamikes se parapare. (Per me teper raporton organi mbikqyres pran zyres per Plan dhe Zhvillim).

\*Punimet ne projektin e ndertimit „Hulumtimi i ujit te pijes te krismat e mushtishtit dhe rezervori V=1000m<sup>3</sup>” punimet janë duke u zhvilluar sipas planit dinamik, gjatë muajit Gusht kemi percjellur implementimin e projektit ku deri me tani nuk ka pasur pengesa ne realizimi e punimeve të parapara me kontrat.

\*Takim ne ZRRUK ku tema e takimit ishte informatat shtese lidhur me Planin e Biznesit 2015-2017, në ketë takim u vendos qe të jepen pershkrimet të projekteve të perfshir në bazë të Plan Biznesit 2015-2017.

\*Pjesemarrja ne evalumin e tenderit per inspektimin dhe vleresimin e fshatrave te financuar nga Qe Kosoves dhe ajo zviceriane me implementues CDI-DORCSH. Ekzistojne raportet shtese.

\*Hartimi i projektit per Galerine per kaojen e ujit te pijes ne fshatin Senik. Ekziston projekti ideor i perpiluar nga inxh. e kompanise.

\*Pershkrimi i projektit per Biznes Planin rregullator tarifor 2015-2017. Posedojme planin rregullator.

\*Hartimi i paramasave dhe parallogarive per rehabilitimin e rrjetit te ujesjellesit ne rruget qendrore te ujesjellesit i cili eshte regjistruar ne PIP-Programin e Investimeve publike ne MZHE per vitin 2015-2017.

\*Vizite ne prishtine me rastin e inaugurimit te investimeve te Qeverise Gjermane-KfW.

Hartimi i projektit per ndrrimin e gypit ekzistues Ø 300mm me ate PE 315 me L=1050m, projekt ky i hartuar nga inxhinieret e kompanise.

\*Takim me anetarin e keshillit nderministror z. Afrim Lajci, ne lidhje me plotesimin e pyetesorit per qeshtjet teknike te cilat kane te bejne me performancen teknike te kompanise.

\*Takim me perfaqesuesit e komunes se Prizrenit per mundesin e e furnizimit me uje te pijes per PARKUN E BIZNESIT. Ekziston raporti i vecant nga z. Lulzim Pacarizi

\*Vizite ne JICA per sqarimin e udhetimit per ne Japoni ne lidhje me ngritjen e kapaciteteve ne sektorin e trajtimit te Ujerave te ndotura.

\*Në cdo muaj janë bërë leximet e ujëmatësve zonal me qellim per te verifikuar hargjimet e ujit nëpër zonat e veçanta. Për me gjerësisht raporton Kordinatori për Planifikim dhe Zhvillim Arian Spahiu.

\*Aktivitete të shërbimit teknik të ndermarrur për eliminimin e humbjeve teknike.

- ✚ Identifikimin dhe menjanimin e lidhjeve ilegale,
- ✚ Rehabilitimin e rrjetit të vjetër të qytetit për eliminimin e humbjeve teknike – dedektimi i rrjetit të ujësjes dhe ndarja e zanave për dedektim.
- ✚ Sensibilizimin e të gjithë konsumatoreve për mos keqpërdorim të ujit të pijes përmes, fletpalosjeve, informatave mediale dhe atyre të shkruara.
- ✚ Ngritjen e vetedijes të të gjithë konsumatoreve që ta paguajnë ujin në mënyrë që të rritet inkasimi dhe të kemi mbulueshmeri financiare e cila do të kthehet konsumatoreve në shërbime dhe investime për shërbim sa më efikas të furnizimit me ujë të pijes.

### 1.1.2 Mirëmbajtja e rrjetit- Sanimi i defekteve - Korrik - Shtator – 2014

**Tabela 1. TM2- 2014**

Njësia Operative	Ujësjesi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	267	189	456
Suharekë	126	18	144
Dragash	10	0	10
Malishevë	81	13	94
<b>Total</b>	<b>484</b>	<b>220</b>	<b>704</b>

**Tabela2 TM3- 2014**

Njësia Operative	Ujësjesi- uji i pijes	Kanalizimi	Total
Prizren	290	269	559
Suharekë	112	21	133
Dragash	03	00	03
Malishevë	99	16	115
<b>Total</b>	<b>504</b>	<b>306</b>	<b>810</b>

### 1.1.3 Zyra për planifikim dhe zhvillim - Korrik - Shtator – 2014

Për periudhën që po raportojmë në kuadër të zyrës së Plan Zhvillimit grupet e organizuara të cilat veprojnë në terren kanë vazhduar bllobimet nëpër qytetin e Prizrenit për të kryer refreshimin këto kanë arritur këto rezultate:

- Ujematësa të bllobuar 382 Ujematësa.
- Kontrata të nënshkruar 382 Kontrata
- Konsumatorët që ekipa jone nuk ka pasur qasje 722 konsumatorë.
- Ribllobim, bllobim për herë të dytë 129.
- Konsumatorët që duhet të regjistrohen 17.



- Konsumator pa ujëmatës 75.
- Konsumatorët që duhet të zëvendësojnë ujëmatësin 04.
- Konsumatorët që janë të bllojuar 293.
- Konsumatorët që nuk kanë lidhje uji (me puse) 02.
- Konsumatorët që nuk pranojnë të kyçen 01.
- Vend i pa pershtatshëm (puse të bllojuar) 10 konsumator.
- Konsumatorët që duhet bërë aktivizim i faturës 02.

**Tabela 3. TM2- 2014**

Nr.	Prizren Total –Gjithësej	Total
1	Bllombim-Kontrata	140
2	Dera Mbyllyr (Heren e dyte)	559
3	Ujematesa te bllokuar	04
4	Pa ujemates	31
5	Zavendsime	21
6	Nuk kane lidhje te ujit	17
7	Rekorde te reja per blockmapping	25
8	Me puse	03
9	Bllombim per here te dyte	81
10	Regjistrim paushall	15
11	Bllombimet e me hershme	731

**Tabela 4. TM2- 2014**

Nr.	Prizren Total –Gjithsej	Total
1	Bllombim-Kontrata	382
2	Ribllombim	129
3	Dera Mbyllyr( Heren e dyte)	722
4	Duhet regjistruar	17
5	Pa ujemates	75
6	Zevendesim	04
7	Jane te bllojuar	293
8	Nuk kane lidhje uji (me puse)	02
9	Nuk pranojne kyçje	01
10	Vend i papershtatshem	10
11	Aktivizim i fatures	02

Bllombimet totale për Prizren dhe Suharekë për muajt Korrik-Shtator.

**Tabela 5.**

Nr	Bllombimet totale, Prizren - Suharekë	Total
1	Bllombim-Kontrata	734
2	Ribllombim	129
3	Jane te bllombuar	293
4	Dera Mbyllyr( Heren e dyte)	891
5	Pa ujemates	138
6	Duhet regjistruar	20
7	Aktivizim të faturës	02
8	Lidhje uji jo (me puse)	242
9	Te pa banushme (ne ndertim)	06
10	Lidhje uji po ne sherbim jo	12
11	Zevendesim	14
12	Regjistrim i ri	01
13	Nuk pranojne kyçje	01
14	Vend i papershtatshem	10

\* Në muajt Korrik-Shtator, grupi i terenit demontim – montim me njësi në Prizren kanë arritur që gjithsej të demontojnë dhe montojnë 353 ujëmatësa, ekzistojnë raporte të veqanta për çdo muaj.

\* Grupi i detektimit të rrjetit të ujësjellësit gjatë muajit Korrik-Shtator ka bërë gjithësej 153 detektime, gjatë detektimit kanë hasur në 112 defekte, ekzistojnë raporte të veqanta për çdo muaj. Po ashtu gjatësia e rrjetit të detektuar është 5,905 m.

\*Po ashtu në muajt Korrik-Shtator kemi pasur 8 raste për riparime të ujëmatësave që janë sjellur nga vetë konsumatorët, ekzistojnë raporte të veqanta për çdo muaj.

\* Është bërë leximi dhe monitorimi i ujëmatësave zonal për muajt Korrik-Shtator, ku ujëmatësat zonal në pikat matëse: Sheshi i lidhjes punime në shesh nuk kemi pas qasje,arsyja puseta e mbuluar, Atmaxhë ujëmatësi nuk lexon për arsye se është bërë një bajpas që nga muaji Korrik ku uji nuk hynë në ujëmatës të KFORI dhe Jusuf Gërvall ujëmatësat zonal janë nën monitorim për arsye të leximit të vogel për këta muaj

Pikat tjera janë kontrolluar dhe rezulton se të gjithë ujëmatësat janë në gjendje të rregullt për muajt Korrik-Shtator.

#### **1.1.4 Shërbimi i mirëmbajtjes – servisimi i ujëmatësve – TM3 – 2014**

Ky sektor është në kombinim edhe me ekipin e mirëmbajtjes së pompave dhe detektimit.

Ky shërbim bën servisimin dhe kalibrimin ujëmatësave të profileve  $\Phi(13-100)$ mm.



Korrik, 2014

\*Përcjellja permanente e klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit;

\*Përcjellja e sistemit të furnizimit prej Bunarlluk I dhe II për rezervuarin e Kurillës së bashku me ekipin e mirëmbajtjes për shkak të humbjes së klorit residual në këtë vi të furnizimit. Këtë e kemi konstatuar pasi që rreth 2 javë klori në këtë vi, O 300, nuk po lajmërohet. Duke menduar se është defekti në pyetje së bashku me ekipin e mirëmbajtjes disa ditë rresht kemi përcjellur klorin residual por, është konstatuar se nuk është defekti në pyetje. Përsëri disa ditë kemi përcjellur këtë vi të furnizimit dhe kemi konstatuar se pompat që e shtyejnë ujin prej Bunarlluk II pengojnë dëpërtimin e klorit në këtë vi. Këtë përsëri kemi konstatuar në mënyrë tjetër duke e ndaluar punën e pompave prej këtij burimi dhe se çdo gjë ka qenë në rregull dhe klori residual është lajmëruar në këtë vi të furnizimit gjegjësidht në tubacionin , O 300. Në lidhje me këtë çështje duhet të ndërmerren masa të duhur dhe të verifikohet se çka është në pyetje që me aktivizimin e dy pompave prej Bunarlluk II klori residual nuk po lajmërohet në këtë vi kurse pa këto pompa klori residual po lajmërohet në të gjitha pikat e furnizimit që ka të bëjë me këtë tubacion.

Të gjitha paisjet e klorifikimit I kemi verifikuar dhe figuron se çdo paisje është duke punuar në mënyrë të rregullt;

\*Kemi vizituar disa herë Njësien e Malishevës për shkak të dyshimit se klori gjegjësisht Na-hipoklorit nuk është në rregull. Por, pas bisedimit edhe me furnitorin prej të cilit kemi kërkuar të na l dërgojë mostrën e klorit për analizë në laborator është konstatuar se klori është në gjendje të rregullt dhe l përgjigjet të gjitha parametrave për këtë llojë klori( në gjendje të lëngët). Për të bidur edhe menaxherin e Njesisë malishevë kemi vizituar dy herë malishevën dhe në vend kemi bindur ata se klori është në gjendje të rregullt dhe se duhet të përmbahen parametrave të parapara për bërjen e tretjes dhe përcjelljes së klorit residual në të gjitha pikate e furnizimit në këtë Njësi;

\*Është bërë montimi i bombolës 1 t me klor gaz në shtëpinë e klorifikimit në Mulli dhe se nuk ka shkaktuar ndonjë problem gjatë instalimit;

\*Janë bërë disa verifikime të ankesave nga ana e konsumatorëve në rrjetat furnizuese ku kanë dyshuar se rrjedhjet a kanë të bëjnë me ujin tonë( të pijes ) apo i takojnë ndonjë rrjedhe ( burimi ) tjetër.

Sipas raporteve të marrura nga ISHP në asnjë analizë nuk figuron klor residual të mjaftueshëm. Duhet të kenë kujdes më të madh gjatë procesit të klorifikimit dhe matjet të bëhen në mënyrë permanente çdo ditë.

Gusht, 2014

Aktivitetet e laboratorit të kompanis K.R.U., „Hidroregjioni Jugor“

\*Përcjellja permanente e klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit ;

\*Jnë marrun 30 mostra nga ana jonë ku të gjitha l përgjigjen standardeve të ujit të pijes përveq atyre në burime dhe në shkollën fillore „Abdyl Frashëri“.

\*Marrja e mostrave në kroje të ndryshme me qëllim të monitorimit sa më të mirë të kualitetit të ujit ,ku gjatë kontrollimit të përhershëm që u bëjmë krojeve nëpër shkolla vërejtëm se në Shkollën Fillore „Abdyl Frashëri“ në ortakoll kemi një situatë ku turbiditeti ( turbullira ) i ujit ishte më i madhë se normat që e lejojnë për ujë të pijes, andaj pas përsëritjes së mostrave disa ditore konstatuam se rrjeti l njërit objekt në këtë Shkollë ishte i dëmtuar dhe e bënte ndotjen e ujit . Ne njoftuam Drejtoreshën e shkollës për problemin dhe këshilluam që uji në këtë objekt nuk duhet të përdoret për pije deri sa të bëjnë ndrimin e gypave për mbrenda objektit. Deri në një vendim të tillë erdhëm pasi të tërë regjionin ( lokalet e ndryshme ) për rreth shkollës e kontrolluam po ashtu edhe objektin tjetër në oborr të po të njëtes shkollë ku uji ishte në suaza të normave të lejuara për konsum.

\*Të gjitha shkollave u dërgua një njoftim që para se të filloj viti l ri shkollor puntorët ndihmës në këto shkolla të lëshojnë ujin që të rrjedhë nga rubinetat e tyre me qëllim që të bëhet pastrami l tyre pasi nuk ka qarkulluar një kohë të gjatë.

\*Vizitë në njësien e Malishevës me kërkesën e tyre për verifikimin e klorit të lëngët (hipoklorurin e natriumit ) dhe verifikuam se qdo gjë me klorin ishte në rregull dhe se duhet që tiu përmbahen parametrave të parapara për bërjen e tretjes dhe përcjelljes së klorit residual në të gjitha pikat e furnizimit në këtë njësi .

\*Janë bërë disa verifikime në lidhje me ujin se a është ai ujë i pijes, si nga shërbimi i operativës ashtu edhe nga ankesat në shtëpi të ndryshme private ku dyshohej se uji a i përket sistemit tone të furnizimit apo ndonji burimi tjetër.

\*Përsëritja e marrjes së mostrave në të gjitha shkollat ku si e cekëm edhe më lartë në të gjitha këto objekte uji i përgjigjet standardeve për ujë të pijes ( përfshirë këtu edhe objektin në shkollën fillore „Abdyl Frashëri “ po ku me sygjerimin tonë janë lanë disa qeshme që uji në to të rrjedh vazhdimisht).

\*Analizat e bëra nga I.SH.P.rezultojnë të jenë prej 75 analizave të marruna në Prizren 3 mostra nuk i përgjigjen standardeve të ujit për pije ( edhe pse në të tria këto mostra klori residual është i pranishëm 02-03 mg/l) në Therand 15 mostra ku të gjitha mostrat i përgjigjen standardeve të ujit të pijes, Dragashi 5 mostra të marruna ku të gjitha i përgjigjen dhe në Malishevë ku janë marrun 2 mostra ( 1 në burim ) dhe që të dyja nuk i përgjigjen ,sepse marrja e mostrave u ba po në të njëjtën ditë kur edhe ne ishim për verifikim dhe futje në system të klorit .

Në Prizren mostrat që nuk i përgjigjen standardeve të ujit të pijes janë marrë 2 në rest, „Fatoni“ dhe një në gjamin Dragoman ku prezenca e klorit ishte 02mg/l sasi kjo që preferohet në ujin e pijes, këto mostra janë përsëritur me date 13,20,25 ku të gjitha ato mostra janë në suaza të ujit të pijes.

Shtator, 2014

Për shkak të pushimeve vjetore nuk kemi mundur të marrim mostra më tepër. Në malishevë 2 herë kemi qenë por për shkak të problemve që kanë pasur me klorifikim nuk kemi marrë mostrat e nevojshme.

Aktivitetet tjera;

\*Për shkak të rreshjeve të mëdha disa herë kemi vizituar 40 bunarët me ç’rast dy prej burimeve i kemi shakarkuar në lumë për shkak të ndotjes (kohëzgjatja e shakarkimit ka qenë 4-5 orë), 2x;

\*Kloraparati i Lubizhdës së Hasit është rregulluar dhe është montuar;

\*Instalimi i bombolës 1 t me Cl-gaz në Mulli;

\*Vizita në Malishevë (2x) për dyshimet që kanë pasur rreth Hipoklorit Natriumit (Eau de Javel) ku i kemi përkujtuar edhe një herë përgaditjen e duhur të tretjes. Vizita është bërë me kërkesë të menagjerit të Njësisë;

\*Në bazë të kërkesës së komitetit për hulumtime dhe zhvillim është bërë vizita në burimin Cvileni dhe janë marrur mostrat si dhe me z.G.Hoda është diskutuar rreth pikave që janë dhënë në mbledhjen e Komitetit për Hulumtim dhe Teknologji.

\*Furnizimi i fshtrave me klor të lëngët;

\*Vizita në Prishtinë në IKSHP, DrBurbuqe Nushi për të diskutuar çështjen e analizave që nuk i përgjigjen stand. të ujit të pijes e që përbëjnë Cl-rezidual dhe është dorëzuar ankesa zyrtare në lidhje me këtë çështje.

\*Përcjellja e klorit residual në mënyrë permanente.

\*Vizita te konsumatori i cili është ankuar për kualitet të ujit. Gjatë vizitës kemi konstatuar se çdo gjë është në rregull.

\*Analizat bakteriologjike për Shtator 2014 janë:

Prizren prej 89 analizave 9 nuk i përgjigjen stand. të ujit të pijes (përbëjnë Cl-rezidua 0.1-05.mg/l);

Suharekë prej 15 analizave të gjitha i përgjigjen stand. të ujit të pijes;

Dragash prej 5 analizave 4 nuk i përgjigjen. Stand. të ujit të pijes;

Malishevë prej 5 analizave 3 nuk i përgjigjen stand. të ujit të pijes;

Është dhënë në tabelë tremujori TM3 për periudhën 01.07.2014-30.09.2014.

## 1.2 RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE – TM2 – TM3- 2014

### 1.2.1 RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE NJ.P-PRIZREN

MUAJI	TM2- 2014	TM3-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<b>Prodhimi m3</b>	3,301,510	3,795,040	493,530	13.00
<b>Faturimi m3</b>	1,355,721	1,588,770	233,049	14.67
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	1,945,789	2,206,270	260,481	11.81
<b>Uji I pafaturuar ne %</b>	58.94	58.14	-0.80	

#### 1.2.1.1 AKTIVITETET KRYESORE

Gjatë TM-3 furnizimi me ujë ka qenë i rregullët, njeherit kemi pasur rritje të prodhimit të ujit prej 493,530 m<sup>3</sup> ose 15.21 % , më shumë ujë të zhfrytëzuar nga tre mujori i pare te vitit 2014.

\*Në këtë tremujor në njësin e Prizrenit kemi arritur të kemi uljen UPF me një ndryshim prej -0.80% duke u falenderuar angazhimeve te ekipes se kontrolles dhe te detektimit.

#### 1.2.1.2 PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË MOS ARRITJEN E OBJEKTIVAVE

\*Nje prej arsyeve që ka ndikuar ne mos arritjen e objektivave nr kete Tre mujor është vazhdimësia e keqepërdorimi i ujit nga ana e qytetarve, numri i madhë i defekteve ne sistemin e ujës-jellësit dhe të kanalizimit, për shkak te rrjetit të vjetërsuar, lidhjet ilegale etj, (numri i madh i defekteve prej 290 raste në rrjetin sekondar 261 raste dhe 29 raste ne rrrjetin primar).

\*Numri i rrjedhjeve në pjesen e nënkalasë ku janë të pa banuar, ku ekipa e dedektimit është në bashkpunim me operative jan duke vazhduar për të gjetur rrjedhjet e ujit.

#### 1.2.1.3 MASAT E REALIZUAR NGA TREMUJORI PARAPRAK

\*Ne TM-2 ka pasur probleme keqepërdorimin e ujit ku edhe ne kete TM-3 ka vazhduar te keqepërdoret, mirepo kemi arritur te ulim vlerat e UPF deri 0.80%

\*Riparimi i defektet - janë realizuar 559 raste.

\*Ne pjesen e nenkalas ka rrjedheje te ujit ku ekipa e detektimit ka arritur te gjen disa rrjedhje dhe vazhdon ne gjetjet tjera, mirpo në kete pjesë jane objekte te pa banuar nga komuniteti Serb.

\*Furnizimi me uje ka qen me i veshtirsuar ne TM-2 per lagjen e Dardanis mirpo gjate kesaj periudhe eshte intervenuar dhe kemi furnizim me te mire ne kete Lagje dhe furnizim te rregullt per shkollen e kompetences.

#### 1.2.1.4 MASAT E PROPOZUARA

\*Ulja e vlerave te UPF-së.

\* Vazhdimi i detektimi të rrjetit.

\*Angazhimet shtes te ekipes se kontrolles dhe te ekipes së detektimit për të gjetur dhe eliminuar sa më shpejt defektet, si dhe gjetjen e lidhjeve ilegale.

\*Vetëdisimi i qytetarve për shfrytëzimin e drejt të ujit të pijes.

\*Bashkëpunimi me institucionet – Kuvendin Komunal etj.

\*Bashkëpunimi në realizimin e projekteve nga CDI, Kfw, etj.

### 1.2.2 RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE-NJ.P-SUHAREKË

MUAJI	TM2- 2014	TM3-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<b>Prodhimi m3</b>	544,612	570,123	25,511	4.47
<b>Faturimi m3</b>	194,898	225,003	30,105	13.38
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	349,714	345,120	(4,594)	-1.33
<b>Uji I pafaturuar në %</b>	64.21	60.53	-3.68	

#### 1.2.2.1 AKTIVITETE KRYESORE

\*Furnizimi me ujë – TM3 – 2014 - Furnizimi me ujë gjatë këtij tre mujori ka qenë kryesisht i mirë dhe pa reduktime, me përjashtim të fshatit Studenqan, ku sasia e ujit që është prodhuar, nuk ka qenë e mjaftueshme për tërë fshatin, si pasojë e zhvendosjes së vendburimit dhe krijimit të një distance më të madhe për thithjen e ujit nga pompat, për shkak të punimeve që po zhvillohen në ndërtimin e kaptazhës së re.

\*Edhe më tutje kemi furnizim jo adekuat në periferi të qytetit të Suharekës dhe atë për shkak të nivelit të ultë të bazenit në Shirokë, prej nga furnizohet qyteti dhe si pasojë kemi shtypje të ultë, ndërsa në pikat më të larta fare nuk ka furnizim.

\*Uji i prodhuar - Për TM-3 të vitit 2014 kemi rritje të sasisë së ujit të prodhuar për 25.411[m<sup>3</sup>], në raport me TM-2 të vitit 2014, pra nga 544.612[m<sup>3</sup>] në TM-2 2014, është ngritur në 570.023[m<sup>3</sup>] në TM3- 2014. Kjo rritje e prodhimit arsyetohet me faktin se janë rritur shpenzimet e ujit në sezonën verore.

\*Uji i pafaturuar - Uji i pafaturuar në TM-3 2014 ka shënuar rënie për 4.694 [m<sup>3</sup>], pra nga 349.714[m<sup>3</sup>] në TM2 2014, në 345.020 [m<sup>3</sup>] në TM3 2014. Megjithatë përkundër masave të vazhdueshme të shërbimit teknik në mirëmbajtjen e rrjetit të ujësjellësit, raportet tregojnë se uji i pafaturuar mbetet në kuotë të lartë, që do të thotë se është një problem i vazhdueshëm dhe i cili kërkon një mobilizim më të përkushtuar të të gjithë mekanizmave institucional edhe jashtë kompanisë tone, në mënyrë që të kemi rezultate më të mira në parandalimin e keqpërdorimit të ujit të pijes.

\*Analizat e ujit – Gjatë TM3 2014 janë realizuar 29 mostra të analizave bakteriologjike dhe të gjitha iu kanë përgjigjur standarëve.

\*Rregullimi i defekteve – Rrjeti primar pa defekte, Rrjeti sekondar 113 defekte, Deblokimi i kanalizimeve 31 ndërhyrje, Stacionet e pompimit pa defekte

\*Vazhdimi i punimeve në hulumtimin e sasisë së re të ujit në pjesën mbi Rezervuarin “Krismat e Sali Shabanit” në Baçevc.

\*Gjashtë ditë të punës, komplet ekipa e Operativës ka qenë e angazhuar në Baçevc, në vendosjen e gypave të ujësjellësit në puset e hapura për prova, në përcaktimin e sasisë së ujit dhe që kjo sasi të vazhdojë të shfrytëzohet për mbushjen e rezervuarit me rënie të lirë.

\*Realizimi i pesë lidhjeve të reja në fshatin Semetisht-Në rrjetin e ri të punuar gjatë vitit 2013, janë kyçur edhe pesë konsumatorë të rinjë të cilët nuk kanë qenë të kyçur më herët në rrjetin e ujësjellësit.

\*Poashtu është kyçur në rrjetin e ri një lagje me gyp DN 63 mm në fund të fshatit Semetisht, për shkak se linja e mëhershme e furnizimit të kësaj lagjeje është bllokuar nga sasia e gurit gëlqeror e cila e ka mbyllur gypin. Për të vendosur gypin e ri për furnizim, është dashur të kalohet rruga e asfaltuar, prandaj është bërë shpimi i rrugës, kurse shpenzimet i kanë bartur vetë konsumatorët.

\*Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e galerisë së re të ujit në pjesën mbi Rezervuarin “Krismat e Sali Shabanit” në Baçevc.

\*Pas përfundimit të punimeve në ndërtimin e tunelit të galerisë, përgjatë pjesës ku kanë qenë të hapura puset e ujit, galeria është vazhduar edhe për një gjatësi prej 30m më poshtë, në mënyrë që të lehtësohet qasja në brendësi të galerisë, ndërsa mbetet të mbulohet krejtësisht nga e sipërme.

\*Nxjerrja dhe vendosja e pompave në puse sipas fuqisë së pompave dhe kapacitetit të ujit në puset ekzistuese.

- Nxjerrja e pompës 9,2 KW në Fidanishte dhe vendosja në Baçevc

- Nxjerrja e pompës 15 KW në Baçevc dhe vendosja te Pusi Atit

- Nxjerrja e pompës 7,5 KW në Baçevc dhe vendosja në Baçevc

- Nxjerrja e pompës 37 KW te Pusi Atit dhe vendosja në depo

- Nxjerrja e pompës 11 KW në Baçevc te lumi dhe vendosja në depo

- Nxjerrja e pompës 7,5 KW në Topallnica – Pompë e djegur

\*Vendosja e pjesëve fazonike të ujësjellësit në kaptazhën e re në Studenqan

Janë vendosur të gjitha pjesët e nevojshme për të dyja sistemet si ai me pompa dhe me rënie të lire ku ka mbetur vetëm vendosja e pompës, ndërsa pjesa me rënie të lire është përfunduar dhe është lëshuar në funksion.

### **1.2.2.2 ARSYET QË KANË NDIKUAR NË ARRITJEN/MOSARRITJEN E OBJEKTIVAVE**

\*Zhvillimi i punimeve në ndërtimin e kaptazhës së re të ujit në fshatin Studenqan ku për pasojë kemi pasur furnizim jo të mirë me ujë.

\*Dëmtimi i rrugëve dhe mungesa e kapaciteteve të njësisë tonë për riparimin profesional të tyre.

\*Investimet e vazhdueshme.

### **1.2.2.3 MASAT E REALIZUAR NGA TREMUJORI PARAPRAK**

\*Gjate TM-3 ne njesin e Suharekës ka vazhduar bllobimi i ujematesave dhe kemi arritur te bllobojm gjithesej 352 ujëmatësa.

\*Vazhdimi i punimeve në hulumtimin e sasisë së re të ujit në pjesën mbi Rezervuarin “Krismat e Sali Shabanit” në Baçevc.

\*Realizimi i pesë lidhjeve të reja në fshatin Semetisht

\*Vazhdimi i punimeve në ndërtimin e galerisë së re të ujit të pijes në pjesën mbi Rezervuarin “Krismat e Sali Shabanit” në Baçevc.



\*Kemi mbajtur takim pune në lokalet e Komunës me qëllim të informimit rreth ecurisë së projekteve të cilat do t'i realizoj CDI-ja në bashkëpunim me KRU "Hidroregjioni jugor", ku nga këto projekte do të përfitojnë 11 fshatra të komunës sonë.

\*Kemi mbajtur një takim me Kryetarin e Komunës me të cilin kemi biseduar rreth projekteve të KRU "Hidroregjioni jugor" dhe CDI-së si dhe për vendosjen e një gypi të ujësjellësit nga Topallnica deri në rrugën e Reqanit.

\*Ndërtimin e tunelit të galerisë, përgjatë pjesës ku kanë qenë të hapura pusët e ujit, galeria është vazhduar edhe për një gjatësi prej 30m.

\*Vendosja e pompave në puse sipas fuqisë së pompave dhe kapacitetit të ujit në pusët ekzistuese.

\*Vendosja e pjesëve fazonike të ujësjellësit në kaptazhën e re në Studenqan.

#### 1.2.2.4 MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS

\*Furnizim te rregullt me ujë te pijes.

\*Blombimi i uëmatësave.

\*Ngritja e vazhdueshme e nivelit të profesionalizmit dhe të përgjegjësisë në punë e **shërbimit operativ** në teren, duke siguruar furnizim sa më të mirë me ujë të pijshëm.

\*Riparimi sa me i shpejt dhe profesional te defekteve.

\*Uljen e vlerave te UPF – eliminimin e rrjedhejve.

#### 1.2.3 RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE-NJ.P-DRAGASH

MUAJI	TM2- 2014	TM3-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<b>Prodhimi m3</b>	107,678	130,892	23,214	17.74
<b>Faturimi m3</b>	53,366	65,378	12,012	18.37
<b>Faturimi nga uji €</b>	35,278.21 €	40,798.50 €	5,520.29 €	13.53
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	54,312	65,514	11,202	17.10
<b>Uji I pafaturuar ne %</b>	50.44	50.05	-0.39	

##### 1.2.3.1 AKTIVITETET KRYESORE

\*Gjatë TM-3 2014 në kompanin e "Hidroregjionit Jugor"njësia në Dragash ka pasur rritje të prodhimit prej 23,214 m<sup>3</sup> ose 23.86 %, kjo rritje e prodhimit është e lidhur me nevojat e konsumatorve për të zhfrytëzuar ujin. Gjendje e furnizimit me ujë gjatë TM-3 ka qenë stabile në të gjithë njesin e Sharrit (Dragashit).

##### 1.2.3.2 PROBLEMET QË KANË NDIKUAR NË MOS ARRITJEN E OBJEKTIVAVE

\* Investimeve të vazhdueshme.

\*Humbjet e ujit

\*Për mos arritjen e objektivave, janë numri i defekteve ne sistemin e ujesjellesit dhe të kanalizimit, për shkak te rrjetit të vjetërsuar.

### 1.2.3.3 MASAT E REALIZUAR NGA TREMUJORI PARAPRAK

\*Kemi shtuar aktivitete ne te gjithë fshatrat e Komunes se Dragashit per të gjetur nje marreveshtje lidhur me menaxhimin e sistemit te ujesjellseve nen Hidroregjionin Jugor.

\*Jemi duke ber inqizimin e gjendjen se fshatrave per projektet kapitale qe do te investohen nga CDI.

\*Eliminimin defekteve ku kemi pasur vetum 3 raste ne rrjetin e ujesjellesit gjate TM-3.

\*Gjatë kësaj periudhe kemi arritur te ulim vlerat e UPF 0.39%.

### 1.2.3.4 MASAT E PROPOZUARA

\*Bashkuimi me instutucionet lokale – Komunen e Dragashit.

\*Bashkuimi me sherbimet tjera për te verifikuar keqëpërdorusit

\* Uljen e vlerave te humbjet e UPF.

\*Shërbimi të shpejt dhe profesional për riparimin e defekteve.

## 1.2.4 RAPORTI I PERFORMANCES OPERATIVE-NJ.P-MALISHEVË

MUAJI	TM2- 2014	TM3-2014	NDRYSHIMI	NDRYSHIMI %
<b>Prodhimi m3</b>	336,322	335,695	(627)	-0.19
<b>Faturimi m3</b>	134,048	147,672	13,624	9.23
<b>Uji I pafaturuar në m3</b>	202,274	188,023	(14,251)	-7.58
<b>Uji I pafaturuar ne %</b>	60.14	56.01	-4.13	

### 1.2.4.1 AKTIVITETET KRYESORE

\*Furnizimi me ujë TM3/2014 - Furnuizimi me ujë ka qene i plotë gjatë 24 orëve ,përveq ne Mirushë , Gurbardh,dhe Turjakë qe kemi reduktime nga 6 ore ne dite nga 20 shtatori/2014 per shkak te djegijes se 1 pompe 18.5 kw .

\*Kualiteti i ujit - TM3 / 2014- Në pajtueshmëii me standardet e OBSH-së.

\*Prodhimi/ TM3 krahasuar me TM2-Ka qenë më i ulët për 627 m3 per shkak se ne muajin shtator kemi pasur nje pompe me pak ne st. Pompues ne Gurbardh (18.5 kw). Per shkak te djegies për 10 ditë rresht.

\*Aktivitete tjera pune TM3: Monitorimi i vazhdueshëm gjatë ekzekutimit të punimeve në shtrirjen e rrjetit të ujësjellesit në fshatin Drenoc ku edhe kanë perfunduar këto punime 32 km rrjet Kryesor.(Investim nga K.K.: IRD : HRJ.

#### 1.2.4.2 PROBLEMET –VËSHIRËSITË QË I KEMI PASUR GJATË TM3 /2014

- \* Mos paisja e te gjithë konsumatoreve me ujemates (10 % te konsumatoreve jane pa ujematesa) dhe paraqiten problemet ne furnizim per shkak te keqperdorimit- matje jo te sakt te sasis te ujit te zhfrytzuar.
- \* Shkallae larte e papunesise ne komunen e Malisheves.
- \* Humbjet e ujit - angazhimit te shtuar te ekipes operative ne evitimin e defekteve .

#### 1.2.4.3 MASAT E REALIZUAR NGA TREMUJORI PARAPRAK

- \*Verifikimi i ujëmatësave-815
- Gjatë këtij tremujori janë nënshkruar 300 kontrata me konsumatorë për riprogramim të borxhit në afat dy dhe trevjeqar. Vlera monetare e kontraktuar është rreth 100 000 euro. Efektet janë të shumëfishta nga nënshkrimi i kontratave : së pari konsumatori pranon borxhin dhe e dyta në rast të mospërbushjes së detyrimeve të kontraktuara , konsumatori mund të paditet në gjykat.
- Janë shkyq tre konsumatorë për lidhje jashtë orës, të cilët janë konstatu që kanë shfrytëzuar ujin në mënyrë të paligjshme.
- Kontrolla në nivel rajonal nga 820 konsumatorë , të cilët kanë borxh mbi 300 euro ka inkasuar 55,144.84 euro
- Destimulimi në pagë mujore për secilin Inkasant i cili nuk plotëson limitin mujor, por edhe stimulimi në bazë të rregullorës për ata që tejkalojnë limitin e përcaktuar
- Tërheqja e vërejtjes me gojë dhe me shkrim për të gjitha parregullsitë që kanë në dokumentacion dhe në teren, duke përfshirë edhe dhënjën e një udhëzimi me shkrim për plotësim të dokumentacionit

### **2.3.6 MASAT E PROPOZUARA PËR PËRMIRËSIMIN E PERFORMANCËS**

- Vazhdimësia e punës së ekipeve të kontrollit për së bashku me operativen për shkyqjen e konsumatorve borgjilin të mëdhej mbi 300,00 euro, të cilët nuk bëjnë pagesa dhe riprogramim të borxhit, në secilin muaj ndërrohet terreni nga një inkasant tek tjetri.Gjtaë tremujorit të katërt ekipet

e kontrollës do të fokusohen te konsumatorët të cilët banojnë në ndërtesa kolektive (banesa). Për secilin muaj në muajt në vijim do të shpërndahen nga rreth 200 njoftime për mospagesë.

- Kontaktet më të shpeshta me konsumator që kanë shumë të larta të borxjeve në mënyrë që të arrihet nënshkrimi i kontratave për riprogramimin e borxjeve në mënyrë që këta konsumatorë të futen në sistemin e pagesave të fakturave. Secili inkasant në terren mund të bëjë kontrata për riprogramim të konsumatorëve të terrenit të tij, të atyre konsumatorëve që kanë borxh mbi 200 euro. Për secilin kontratë të nënshkruar inkasantët do të stimulohen më një pagesë prej 5 eurove.
- Konsumatorët të cilët shkyqen nga rrjeti për mos pagesë nuk do të rikyqen pa i paguar së paku 30% të borxhit total. Të këto raste nuk do të bëhet rikyqja pa u bërë një pjesë e pagesës dhe të nënshkruhet kontrata për riprogramim të borxheve.
- Marrja e masave ligjore sipas Zyres Rregullative për shkyqjen e konsumatorëve për mos pagesë. Secili konsumatorë para shkyqjes duhet të njoftohet bazuar në procedurat ligjore nga Zyra Rregullative.
- Rritja e efikasitetit të ekipes së kontrollës dhe ekipes së shkyqjes.
- Inicimi i padive të konsumatorëve në gjykatë për mos pagesë. Tek rastet ku nuk ka mundësi teknike të shkyqjes ato raste do të inicohen në gjykatë për zgjidhjen e problemit të borxhit.
- Limitimi apo normimi i kontrollës për mbledhjen e borxjeve aty ku kanë vështirsi inkasantët. Në secilin muaj do të caktohet një terren dhe kontrolla do të merret me konsumatorët që nuk paguajnë borxhet.

## 2.4 RAPORT I MEDIAVE – KORRIK-SHTATOR 2014

### KORRIK

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI	TJERA
1	09.07.2014	TV- BESA TV- OPINION TV-PRIZRENI	QENDRA E KOMPETENCËS TANI E TUTJE ME 24 ORË UJË	
2	10.07.2014	KOHA DITORE	ARTIKULLI:KEQPËRDORUESIT I LËNË PA UJË BANORËT E PJESËVE TË LARTA-NJËSIA MALISHEVË	
3	11.07.2014	TV- PRIZRENI	PRONONCIM LIDHUR ME MUNGESËN E UJIT NË RRUGËN " SOZI ÇELEBIU"	
4	11.07.2014	<a href="http://www.tv-opinion.tv">www.tv-opinion.tv</a>	ARTIKULLI:KRU"HIDROREGJIONI JUGOR" NË PRIZREN, BËN EVIDENTIMIN E SAKTË TË KONSUMATORËVE TË SAJ, QË JETOJNË NËN ASISTENCË SOCIALE	
5	14.07.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM:NDËRPRERJE E FURNIZIMIT PËR SHKAK TË PUNIMEVE TE SHESHI I LIDHJES	
6	15.07.2014	KOSOVA SOT	ARTIKULLI:QENDRA E KOMPETENCËS 24 ORË UJË	
7	16.07.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM:NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA FSHATRA, PËR SHKAK TË MUNGESËS SË RRYMËS NË	

			" SOZI"	
8	16.07.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM:NDËRPRERJE E FURNIZIMIT, PËR SHKAK TË PUNIMEVE TE SHESHI I LIDHJES	
9	17.07.2014	<a href="http://www.tv-opinion.tv">www.tv-opinion.tv</a>	ARTIKULLI: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË NË DISA LAGJE DHE FSHATRA	
10	23.07.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM:NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË, PËR SHKAK TË DEFEKTIT NË REZERVUARIN SHPATI	

## GUSHT - 2014

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI	TJERA
1	06.08.2014	KOHA DITORE	ARTIKULLI: SHESHI I LIDHJES PA RRJET KANALIZIMI	
2	06.08.2014	<a href="http://www.prizrenpress.com">www.prizrenpress.com</a>	ARTIKULLI: SUHAREKË- UJËSJELLËSIT E 11 FSHATRAVE NUK MENAXHOHEN NGA "HIDROREGJIONI JUGOR"	
3	06.08.2014	<a href="http://www.prizrenpress.com">www.prizrenpress.com</a>	ARTIKULLI: PRITET REHABILITIMI I NËNTË UJËSJELLËSVE NË MALISHEVË	
4	20.08.2014	TV-PRIZRENI	PRONONCIM: "HIDROREGJIONI JUGOR" ZGJIDH TELASHET PËR BANORËT E RRUGËS "SOZI QELEBIU"	
5	21.08.2014	<a href="http://www.prizreni.tv">www.prizreni.tv</a>	ARTIKULLI: PAS RAPORTIMIT NË TV-PZ, KRU "HIDROREGJIONI JUGOR" ZGJIDH TELASHET PËR FURNIZIM ME UJË TË BANORËVE NË RRUGËN "SOZI QELEBIU"	
6	28.08.2014	KOHA DITORE	ARTIKULLI: UJI I PIJSHËM DHE INFRASTRUKTURA- BRENGAT KRYESORE TË QYTETARËVE TË PRIZRENIT	
7	29.08.2014	<a href="http://www.tv-opinion.com">www.tv-opinion.com</a>	ARTIKULLI: KËRKESAT E QYTETARËVE PRIZRENAS PËR KRYETARIN MUJA-FURNIZIMI MË I MIRË ME UJË	

## SHTATOR

Nr	DATA	MEDIAT	PËRSHKRIMI	TJERA
1	01.09.2014	MJETET E INFORMIMIT PRIZREN	NJOFTIM: NDËRPRERJE E FURNIZIMIT ME UJË, PËR SHKAK TË DEFEKTIT NË KABLLON E TENSIONIT TË LARTË	
2	01.09.2014	www.prizrenpress.com	ARTIKULLI: "TUSUZI" NË TERR DHE PA UJË	
3	01.09.2014	www.prizreni.tv	ARTIKULLI: "TUSUZI" QE DY DITË PA UJË E ENERGJI ELEKTRIKE	
4	17.09.2014	KOHA DITORE	ARTIKULLI: ZVARRITET NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT TË DRENOCIT	
5	23.09.2014	www.rtklive.com	ARTIKULLI: DISA LAGJE TË PRIZRENIT PO PËRBALLEN ME MUNGESËN E UJIT	
6	23.09.2014	<a href="http://www.gazetaexpress.com">www.gazetaexpress.com</a>	ARTIKULLI: MUNGESA E UJIT TË PIJES PRIVIM I TË DREJTAVE NJERËZORE	
7	23.09.2014	www.koha.net	ARTIKULLI: DISA LAGJE TË PRIZRENIT PO PËRBALLEN ME MUNGESËN E UJIT	
8	23.09.2014	<a href="http://www.kosovasot.info">www.kosovasot.info</a>	ARTIKULLI: MUNGESA E UJIT TË PIJES PRIVIM I TË DREJTAVE NJERËZORE	
9	23.09.2014	<a href="http://www.kosovapress.com">www.kosovapress.com</a>	ARTIKULLI: DISA LAGJE TË PRIZRENIT PO PËRBALLEN ME MUNGESËN E UJIT TË PIJSHËM	
10	23.09.2014	<a href="http://www.gazetaeprizrenit.com">www.gazetaeprizrenit.com</a>	ARTIKULLI: MUNGESA E UJIT TË PIJES PRIVIM I TË DREJTAVE NJERËZORE	
11	23.09.2014	<a href="http://www.prizreni.tv">www.prizreni.tv</a>	ARTIKULLI: EC MA NDRYSHJE SHPREH SHQETËSIMET E PRIZRENASVE- MUNGESA E UJIT TË PIJES PRIVON TË DREJTAT NJERËZORE	
12	23.09.2014	<a href="http://www.tv-opinion.com">www.tv-opinion.com</a>	ARTIKULLI: QYTETARËT ANKOHEN NË LIDHJE ME FURNIZIMIN ME UJË TË PIJES	
13	23.09.2014	<a href="http://www.prizrenpress.com">www.prizrenpress.com</a>	ARTIKULLI: EC MA NDRYSHJE - MUNGESA E UJIT TË PIJES PRIVIM I TË DREJTAVE NJERËZORE	
14	24.09.2014	KOSOVA SOT	ARTIKULLI: SHUMË LAGJE TË QYTETIT PA UJË TË PIJSHËM	
15	24.09.2014	<a href="http://www.tv-opinion.com">www.tv-opinion.com</a>	ARTIKULLI: RRJETET E UJËSJELLËSVE TË FSHATRAVE SYNOHEN TË FUTEN NËN MENAXHIMIN E KOMPANISË "HIDROREGJIONI JUGOR"	
16	24.09.2014	TV-OPINION	NËNSHKRIMI I MARRËVESHJES QË UJËSJELLËSIT E ZONA VE RURALE TË MENAXHOHEN NGA KOMPANITË RAJONALE	

17	24.09.2014	TV-BESA	KOMPANIA " HIDROREGJIONI JUGOR" NËNSHKROI MEMORANDUM MARRËVESHJE PËR VENDET RURALE
18	24.09.2014	TV-PRIZRENI	NËNSHKRUHET NË PRIZREN MARRËVESHJA QË UJËSJELLËSIT E ZONAVE RURALE TË MENAXHOHEN NGA KOMPANITË RAJONALE
19	25.09.2014	<a href="http://www.prizreni.tv">www.prizreni.tv</a>	ARTIKULLI: NËNSHKRUHET NË PRIZREN MARRËVESHJA QË UJËSJELLËSIT E ZONAVE RURALE TË MENAXHOHEN NGA KOMPANITË RAJONALE
20	25.09.2014	ZËRI	ARTIKULLI: PRIZRENAS, E HAPIN PUSE PËR UJË

### III. RAPORT I DEPARTAMENTIT ADMINISTRATIV

#### 3.1 Aktivitetet Korrik-Shtator 2014

Departamenti i administrates gjatë këtij tremujori është marrur me përgaditjen e raportëve dhe informatave nga veprimtaria e shërbimit juridik, varësisht nga detyrat dhe obligimet e punës të parapara për këtë departament.

- Gjatë këtij tremujori janë përgaditur të gjitha procesverbalet dhe vendimet e dalura nga Bordi i Drejtorëve, Komisioni i Auditimit, komiteti i financave, komiteti për hulumtime dhe teknologji, komiteti për staf dhe shperblime dhe Kryeshefi Ekzekutiv.
- Është njoftuar me kohë Bordi i Drejtorëve dhe NJPMNP për skadim e kohëzgjatjes së kontratave të punës të Zyratrëve të lartë të Kompanisë-Kryeshefit Ekzekutiv dhe Auditorit të Brendshëm të cilat me pastaj janë vazhduar nga Komisioni i Auditimit (për AB) dhe Bordi i Drejtorëve (për KE).
- Shërbimi juridik ka përgatitur kontratat në mes të kompanisë dhe palëve të treta nga lamia e veprimtarisë së Kompanisë.
- Gjithashtu ky shërbim lëshon për të punësuarit të gjitha llojet e aktvendimeve, autorizimeve dhe vërtetimeve nga fusha e marëdhënieve të punës.
- Janë përgaditur Vendime për mbikqyrje të punimeve dhe pranim teknik te punimeve për projektet e investuara me mjetet vetanake të Kompanisë dhe nga buxheti i Komunave te njesive punuese sipas kërkesës së shërbimit teknik.
- Është përtrirë Marrëveshja e Shërbimit për shërbimet e ujësjellësit dhe ujrave të zeza edhe me Komunen e Malishevës, e cila pas skadimit të afatit fillestar është vazhduar edhe për katër(4) vjet të tjera.
- Është përgaditur dhe shpallur në shtypinë ditorë 1 (një) konkurs për vend pune roje te bunari 1 në njësinë e Prizrenit.
- Janë bërë ndërrime në pozitat e vendëve të punës me pelqimin e punëdhënësit dhe punëmarrësit varësisht nga dinamika e punës dhe nevojat e domosdoshme të Kompanisë.
- I është ndërprer kontrata e punës një punëtori-inakasant në njësinë e Suahrekës(B.E) ngase nuk është lajmëruar disa ditë në vendin e tij të punës dhe nuk ka bërë asnjë njoftim për mosardhjen e tij në punë. Poashtu në njësinë e Suharekës një punëtori(L.S) me marrëveshje në mes të punësuarit-inkasant dhe Kompanisë i është ndërprerë kontrata e punës.



- Kanë bërë punë praktike profesionale student të Univerzitetit të Prizrenit dhe Prishtinës në fushën e Kontabilitetit, Menaxhimit të burimeve njerzore, Menaxhimit të Projektëve, në fushën e Informatikës dhe Komunikimit. Puna praktike profesionale është zhvilluar në mbikqyrje të udhëheqësit nga shërbimit përkatës.
- Përgjigjie NJPMNP që nuk kemi pasur kerkesë për qasje në dokumentet publike për periudhën janar-qershor 2014 nga asnjë profil i aplikuesve dhe se në të ardhmen nese paraqiten kërkesa të tilla do të trajtohen në përputhje me Ligjin Nr.03/L-215 për qasje në dokumente publike.
- Mbështetur në Procedura për Mbikqyrje dhe Monitorim e NP Qendrore pika nent(9), është njoftuar me kohë Bordi i Drejtorëve dhe NJPMNP për mungesën e Sekretarit të Kompanisë në punë (pushim vjetor) nga dt.07.07.2014 deri me 18.07.2014.
- Është njoftuar Zv.Kryeshefi Ekzekutiv për takimin e Bordit te mbajtur me dt.26.06.2014 me ç’rast është diskutuar nga Bordi i Drejtorëve qështja e pjesmarrjes se Zv.Kryeshefit Ekzekutiv në takimet e Bordit dhe që është vendosur nga Bordi për pjesmarrjen e Zv.Kryeshefit Ekzekutiv në takimet e Bordit të Drejtorëve si vezhgues apo pjesmarrës pa të drejt vote.
- Kemi pranuar nga zyra e Auditorit të Përgjithshem “Raportin e Auditimit për kompensimet e Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore për periudhen 2009-2012”
- Është realizuar takim pune me përfaqësuesin e Këshillit Ndërmnistror për Ujëra, me temë të diskutimit:1.Arkëtimi i faturave/Sistemi i menaxhimit të borxheve,2.Uji i pa-faturuar/humbjet e ujit,si pas kërkesës së tyre në menyrë elektronike është plotësuar dhe derguar pyetëtori nga shërbimet e Kompanisë.
- Jemi njoftuar nga NJPMNP lidhur me përmbushjen e kërkesës ligjore nga Ligji mbi NP Nr. 03/L-087, neni 28 per Vlerësimin e Efektshmërisë së Bordit të Drejtorëve,me qrast MZHE ka kontraktuar një kompani konsulente e cila do te bej vlerësimin e Bordeve të Drejtorëve të Ndërmarrjeve Publike Qendrore .

#### PERSONELI – KORRIK– SHTATOR 2014

Muajt	Nr.i te punsuarve sipas muajve	Vende te plotësuar	Te larguar	Të pensionuar	Verejtje
Korrik	302	0	2	0	3 punt.push.pa pages (S.GJ;F.J;S.B)
Gusht	300	0	2	0	
Shtator	300	2	0	0	

#### NUMRI I PUNËTORËVE SIPAS NACIONALITETEVE - GJENDJA: SHTATOR - 2014

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR“ SH.A					
Nacionaliteti	Shqiptarë	Boshnjak dhe Musliman	Romë, Ashkali dhe Egjiptas	Turq	Gjithsejtë numri i punëtorëve
Numri i Punëtorëve	247	36	6	11	300
Numri i Punëtorëve në %	82.3	12.0	2.0	3.7	<b>100</b>

## NUMRI I PUNËTORËVE NË 1000 KONSUMATORË DHE SIPAS GJINISË

GJINIA:	NR	NR. %	Nr. Në 1000 Kon.
FEMRA:	33	11.00	
MESHKUJ:	267	89.00	
TOTAL	300		

## KUALIFIKIMI I PUNËTORËVE - GJENDJA: SHTATOR 2014

K.R.U „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A								
KUALIFIKIMI								
Kualifikimi	Fakultet	Bachelor	Sk.K. e lartë	Sh. e mesme	Sh.N.E	Shkolla fillore	Pa kualifikim	Gjithsejë
Nr. i punetorëve	29	20	0	194	0	52	5	300
Kualifikimi në %	9.67	6.67	0.00	64.67	0.00	17.33	1.67	

## 3.2 RAPORT LIDHUR ME PUNËT E KRYERA ME GJYQËSORIN- TM3 2014

Periudha raportuese	Padi	Përgjigje në padi	Propozim për Ekzekutim	Kallëzime Penale	Seancat përgatitore	Seancat kryesore	Seancat e shtyra	Deklarata në Prokurori	Parashtresa në Gjykata	Parashtresa në Prokurori	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruar nga Kompania	ANKESA në Gjykatën e Apelit të parashtruar nga	Përgjigje në Ankesat e Parashtruar në Gjykatën	Kundërshtimet nga	REVIZION	Përgjigje në Revizion	Vendimet e Revizionit	TOTALI	Totali i lëndëve të ardhura nga Gjykatat
KORRIK	/	1	/	/	1	1	1	/	2	/	1	/	/	1	/	/	/	8	11
GUSHT	/	/	1	/	1	1	/	/	1	/	1	/	/	/	/	/	/	5	3
SHTATOR	/	/	9	2	2	2	2	/	1	/	/	/	/	/	/	/	/	18	5
<b>Totali</b>	<b>/</b>	<b>1</b>	<b>10</b>	<b>2</b>	<b>4</b>	<b>4</b>	<b>3</b>	<b>/</b>	<b>4</b>	<b>/</b>	<b>2</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>1</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>31</b>	<b>19</b>

## PARASHTRESA

- Është bërë Parashtresë për Gjykatën Themelore në Prizren – Dega në Dragash, me ç`rast kemi kërkuar që Aktgjykimi, P.nr. 116/03, datë 08.05.2013, i dhënë nga kjo gjykatë të na sjellet edhe në gjuhën Shqipe.
- Është bërë Parashtresë për Gjykatën Themelore në Prizren – Dega në Dragash, me ç`rast kemi kërkuar fotokopjet e Provave nga lënda e Aktgjykimit, P.nr. 116/03, datë 08.05.2013, pasi që Padia ka ardhur pa asnjë nga Provat e parashtruar të paditësit.

- Është Kërkuar nga Dega e Gjykatës Themelore në Suharekë për transferimin e lëndës C.nr.189/10 te përmbartuesi privat, pasi që nga Gjykata nuk po Përmbartohet kjo lëndë.
- Është përpiluar dhe dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren Parashtresë për caktimin e përfaqësuesit të Përkohshëm (Nazim Danjollit - djali i të ndjerit) në Lëndën e Zeqir Danjollit.
- KEDS-it i është dërguar Njoftim lidhur me dëmet e shkaktuara Kompanisë si pasojë e ndërprerjes së energjisë elektrike me kërkesë për kompensimin e dëmit të shkaktuar ndaj Kompanisë në lartësi prej 20.142.23 € (Njëzetë mijë e njëqindtë e dyzet e dy €uro e tridhjetë e tri cent) në afat prej 10 (dhjetë) ditësh.

#### TË NDRYSHME

- Nga Ministria e Drejtësisë, Zyra Rajonale në Prizren (Shërbimi Sprovues i Zyrës Rajonale në Prizren), ka ardhur Njoftim sipas të cilit Njoftohemi se kjo Zyrë respektivisht Menaxherja e kësaj Zyre me kohë e ka njoftuar ish Gjykatën Komunale në Prizren për mospërbushjen e obligimit ligjorë nga ana e të miturve Besfort dhe Redon Hodaj, ku si dëshmi e prezanton Raportin me nr. M.D. 86/87/12, të datës 22.08.2012.
- Është sjellë nga Gjykata e Themelore në Prizren Aktvendim, IV. Gja.nr. 1/14-62, datë 10.07.2014, sipas të cilit Aprovohet Kërkesa e Gjyqëtarit Agron Hoxhaj për përjashtimin e tij nga udhëheqja e procedurës dhe vendosjes sipas lëndës përmbartimore CP.nr. 1494/13, të Gj.Th. në Prizren pasi që gjyqtari është në lidhje krushqie me Debitorin Asman Hoxha.
- Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim, C.nr. 890/11, datë 16.07.2014, sipas të cilit konsiderohet e tërhequr Padija ndaj Debitorit Shaban Berisha, Rr.Xheladin Hana, nr.12, në Prizren për shkak se Padija e ka njoftuar Gjykatën se e ka tërhequr Padija ngase palët ndërgjygjëse kanë arritur marrëveshje mbi pagesën e shumës së borxhit.
- Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Parashtresë e propozuesit të përmbartimit lidhur me lëndën C.nr. 803/14, ku Kreditori Njazi Ademaj i drejtohet Ghyka-tës Themelore me Kërkesë që të ftoj ekspertin për përcaktim të vendit të punës sipas ORGANOGRAMIT mbi sistematizimin e vendeve të punës.

#### PËRGJIGJE NË PADI

- Me date **04.07.2014**, është dërguar në Gjykatën Themelore në Prizren Përgjigje në Padi-në ndaj Padi së ardhur me datë 23.06.2014,e evidentuar me C.nr. 391/12, datë 20.06.2014, nga Padija Durak Jasharaj.

#### PËRGJIGJE NË PRAPSIM

- Me datë 15.08.2014, kemi shkruar një Përgjigje në Prapësim ndaj Prapësimi të Debitorit për borxh z. Zeqir Danjollit.

#### ANKESA DHE PARASHTRESA NË GJYKATËN E AELIT NGA KRU

- Është bërë **Ankesë** ndaj Aktgjykimit P.nr. 116/03, datë 08.05.2013, kundër Xhezair Bajrami të cilën e kemi dërguar përmes Postës së Kosovës,pastaj është bërë edhe Plotësimi i Ankesës lidhur me Lëndën C.nr. 116/03, Xhezair Bajrami.

#### VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE NË FAVOR TË KOMPANISË

- Është sjellë nga Gjykata e Apelit në Prishtinë Aktgjykim, GZ.br. 1996/2013, datë 04.02.2014, (lidhur me Aktgjykimin e Gj,Th. Të Prizrenit me C,nr. 173/04, datë 28.02.2013) sipas të cilit refuzohet Ankesa e debitorit Feta Osmanolli nga Prizreni lidhur me borxhin ndaj Kompanisë sonë, Vërtetohet Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren.
- Është pranuar nga Gjykata e Themelore në Prizren Aktvendim, C,nr. 281/14, datë 30.06.2014 sipas të cilit hudhet poshtë Padia (Për vërtetim të borxhit) e Paditëses Arijeta Zengin si e palejuar.
- Nga Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim, C. nr. 803/14, datë 20.08.2014, sipas të cilit refuzohet si i pabazuar Propozimi për Përmbarim i Kreditorit të Përmbarimit Njazi Ademaj, f.Zhur nga Prizreni.
- Nga Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim, P. nr. 115/14, datë 22.09.2014, sipas të cilit caktohet z. Nazim Danjollli nga Prizreni përfaqësues i përkohshëm djali i tani të ndjerit – Zeqir Danjollli nga Prizreni.

#### **VENDIMET NGA GJYKATA THEMELORE KUNDËR KOMPANISË**

- Është sjellë nga Gjykata e Themelore në Prizren Aktgjykim, P.nr. 116/03, datë 08.05.2013, sipas të cilit kërkohet nga Kompania jonë që ta kompensojë në mënyrë solidare me Ekoregjionin z. Xhezair Bajrami nga Dragashi lidhur me Shkëputjen e Kontratës mbi ndërtimin e lokalit afarist.
- Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim Plotsues, E. nr. 1195/12, datë 29.08.2014, sipas të cilit caktohen Shpenzimet e Procedurës së Përmbarimit në shumën prej 500 E, ndaj Kreditorit të përmbarimit z. Njazi Ademaj, f. Zhur, KK Prizren lidhur me Kontest Pune.
- Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Aktgjykim, PAKR. nr. 195/14, datë 24.06.2014, sipas të cilit Refuzohet si e pabazuar Ankesa e Prokurorisë Themelore – Departamenti për Krime të Rënda (DKR) në Prizren, P.nr. 329/2013, datë 10.02.2014 në rastin Gëzim Doda.

#### **KONKLUZION**

- Nga Gjykata e Themelore në Prizren KONKLUZION, E,nr. 142/2006, datë 04.07.2014, sipas të cilit shtyhet procedura përmbarimore sipas njoftimit të bërë nga Kreditori i përmbarimit, ndaj Debitorit Haxhi Ferati, Rr.Vrrinit,nr.30.në Prizren, pasi që është arritur marrëveshja për pagesën e kredisë me këste.
- Nga Gjykata e Themelore në Prizren KONKLUZION, E,nr. 671/2007, datë 04.07.2014, sipas të cilit shtyhet procedura përmbarimore sipas njoftimit të bërë nga Kreditori i përmbarimit, ndaj Debitorit Ymer Spahiu, Rr. Kasambeg, nr.79/A, në Prizren, pasi që është arritur marrëveshja për pagesën e kredisë me këste.
- Nga Gjykata e Themelore në Prizren KONKLUZION, E,nr. 1355/2006, datë 04.07.2014, sipas të cilit shtyhet procedura përmbarimore sipas njoftimit të bërë nga Kreditori i përmbarimit, ndaj Debitorit Osman Zymberaj, Rr.Ulqinit, nr. 146, në Prizren, pasi që është arritur marrëveshja për pagesën e kredisë me këste.

#### **NDËRPRERËJET E PROCEDURAVE SI PASOJË E VDEKJES SË DEBITORËVE**

- Është sjellë nga Gjykata e Themelore në Prizren AKTVENDIM, C,nr. 1071/12, datë 30.06.2014, sipas të cilit NDËRPRITET procedura juridike kontestimore ndaj Debitores Hatixhe Sallauka, Rr. Janinës nr.7 në Prizren për shkak të vdekjes së debitorës.
- Është sjellë nga Gjykata Themelore në Prizren Aktvendim, C. nr. 391/12, datë 31.07.2014, sipas të cilit ndërpritet Procedura në këtë çështje Juridike-kontestimore për shkak të vdekjes së Paditësit Durak Jasharaj, Rr. Nuhi Elezi, nr. 90 nga Prizreni.

### Paraqitja tabelore e Vendimeve të lëshuara nga Ankesat e konsumatorëve

Muaji	Sasia e Vendimeve të lëshuara	Vërejtje
Korrik	18	
Gusht	44	
Shtator	31	
<b>Totali</b>	<b>93 Vendime</b>	

### Masat e ndërmarra nga Gjykata Themelore në Prizren lidhur me Paditë e bëra nga KRU për kyqjen ilegale të konsumatorëve për periudhën kohore Korrik - Shtator 2014

Gjatë periudhës kohore Korrik - Shtator 2014, nga Gjykata Themelore, **Divizioni për Kundërvajtje** në Prizren, janë shqyrtuar gjithsej **5 ( pesë ) Fletëparaqitje për kyqje apo rikyqje ilegale**.

1. Për **1 (një)** Kërkesë është shqiptuar **masa – plotësimit**;
2. Për **2 (dy)** Kërkesa është shqiptuar **masa – pezullim**;
3. Për **2 (dy)** Kërkesa është shqiptuar **masa – qortimit**;
4. Nuk ka pasur shqiptim të **masave të dënimit në të holla**.

Tremujori i III-të	Masa e qortimit	Masa e plotësimit	Masa e pezullimit	Masa e dënimit në Euro	Të kryera gjithsej	Shuma totale e dënimeve në E
<b>Korrik</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>/</b>	<b>5</b>	<b>/</b>
<b>Gusht</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>
<b>Shtator</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>	<b>/</b>
<b>Totali</b>	<b>2</b>	<b>1</b>	<b>2</b>	<b>/</b>	<b>5</b>	<b>/</b>

### 3.3 Raport rreth punës së zyrës së teknologjisë informative TM3- 2014

#### 1. Përshkrimi hyrës;

Aktivitetet e punës së përditshme detalisht janë pasqyruar në raportet ditore të cilat plotësohen në fund të orarit të punës. Këto raporte janë të gatshme në çdo kohë të prezentohen para autoriteteve dhe udhëheqësve të Kompanisë.

Janë disa angazhime të përditshme që ekzekutohen konform detyrimeve të vendit të punës për operim dhe funksionimit optimal të sistemit në përgjithësi dhe të cilat nuk evidentohen çdo herë në raporte për shkak të përsëritjes.

Prandaj ky raport shtron kryesisht aktivitetet e përmbledhura duke veçuar ndonjë punë ekzekutuese që ka patur peshe dhe ndikim të veçantë.

## 2. Raporti

- Asistencë profesionale për funksionimin normal dhe optimal të rrjetit kompjuterik në bazë dhe në njësi të kompanisë.
- Nderhyrje në njësinë e Malishevës (print, server, vpn router, klient) : 16 herë.
- Nderhyrje në njësinë e Therandës (print, server, vpn router, klient) : 20 herë.
- Nderhyrje në njësinë e Dragashit (print, server, vpn router, klientë): 9 herë.
- Nderhyrje në njesitë Shatërvan: 18 herë.
- Nderhyrje në njesitë Depo: 7 herë.
- Nderhyrje në njesinë Filtrat: 27 herë.
- Nderhyrje në Ueb Faqe 4 herë.
- Nderhyrje në Bazë (print, server, vpn router, klientë, fotokopje) : 327 herë.
- Përkujdesje për qasjen e kompanisë në rrjetin e internetit.
- Përkujdesje për menaxhimin dhe mbarëvajtjen e punës së serverit qendror, programit NAVISION, serverave të Njërive, serverit të GIS sistemit dhe sigurisë së të dhënave.
- Asistencë teknike për funksionimin normal të rrjetit telefonik lokal dhe fiks.
- Planifikim i infrastrukturës së mëtutjeshme në bazë të nevojave dhe kërkesave të kompanisë
- Riparim harvderik dhe softverik të paisjeve kompjuterike, programeve aplikative operacionale që shfrytëzohen në Kompani.
- Mbikqyrje rreth zbatimit të kontratave të furnizimeve dhe servisimeve të paisjeve kompjuterike e paisjeve të ngjajshme teknike.
- Përkujdesje për licencimin - vazhdimin e licencimit të programeve operative të kompanisë.
- Përditësim i ueb faqes së Kompanisë.
- Furnizimi me Serverin e ri të dedikuar për Databazë.
- Kemi krijuar arka dhe perdorues të rinje, në përputhje me kërkesat e Kompanisë.
- Zhvillim i trajnimeve praktike dyjavore me studentin e Universitetit të Prizrenit – Doruntina Sertolli.
- Konfigurim i virtual servereve në përputhje me kërkesat e Kompanisë.
- Përkujdesje ditore në ruajtjen e shënimeve të serverëve.
- Konfigurim i serverit të ri të databazës; IBM x3630 m4 me 24 cpu (logjik), 2 fizik dhe 24GB RAM.
- Krijimi i serverit antivirus, Symantec Endpoint Protection, për shpërndarje të antivirusëve në klientet (kompjuteret) e Kompanisë.
- Krijimi i serverit ësus për përditësimet e kompjuterëve nga serveret e microsoft.
- Krijimi i backup serveret e njesive, në rast demtimi, humbje e shënimeve, serveret tjere mbajnë kopje të servereve kryesore.
- Furnizimi me një fotokopje të re, Xerox ëorkcentre 3545, për printimin e faturave dhe ka funksionur shumë mire.

- Furnizimi me 5 kompjutere te rinje, lenovo 2.9Ghz Cpu, 2GB RAM, 19" Samsung monitor. Nje eshte nda ne baze tek zyra e logjistikes, nje tek Filtrat, dy ne njesine e Therandes, nje ne Shatervan.

### **3. Komentet dhe vërejtjet,**

- Zgjidhja e problemeve me kontraktorin për furnizimi me paisje të IT. Si duket kjo është pjesa më e përsëritur në raportet tre mujore të zyrës së IT-së. Ka një vit që e drejtojmë këtë shqetësim.
- Disa nga zyret e Kompanisë kanë shumë printerë personal: Financat (6), GIS (3), si dhe zyret e vogla me 2-4 perdorues kane secili nga nje printer.
- Kabineti ekzistues kompjuterik nuk është në gjendje optimale sa i përket lokacionit, sistemimit të ventilimit, sigurisë, burimit energjetik e të ngjajshme.
- Shenimet per web faqe.
- Nderrimet e switch-eve.

### **4. Propozimet – kërkesat**

- Kompletimi dhe sjellja e rregullt e shenimeve për web faqe. Meqenese web faqja është ndertuar në atë menyre qe aktualitetet, oraret e reduktimeve të ujit të pijes, aktivitetet e prokurimit, dokumentet duhen perditesuar, atehere do te ishte mire qe te sillen nga sherbimet perkatese. Për 3 muaj përditësimet janë bërë vetëm 4 herë në 3 muaj.
- Disa zyre kanë printerë të tepërt. P.sh zyra e financave ka 7 punëtorë dhe të gjithë kanë printerë personalë. E nevojshme do të ishte të vendosja vetëm një printer dhe punëtorët t'i qaseshin atij printeri në lidhje. Ka edhe raste të tjera në Kompani.
- Instalimi i mëparshëm i rrjetit kompjuterik i hasur në objekt ka vendosur kabinetet kompjuterike (RACK) në koridor i cili për shkaqe sigurie dhe të tjera nuk preferohet prandaj propozoj dhe kërkoj që të sigurohet një kthinë e veçantë brenda objektit me kushte të parapara ventilimi e sigurie që kabineti i tillë të vendoset në te. Me këtë aksion do të mënjanohet edhe vërejtja rreth gjendjes dhe sistemimit të kabineteve kompjuterike. Duhet gjetur hapësire (dhome) e posaqme per vendosjen e te gjithë servereve ne te.

## 5. Synimet për 3-mujorin e ardhshëm

- Ndërrimi i sëitch-eve të rrjetave dhe marrja e disave me të shpejte (10/100/1000Mbps) pasi numri i klienteve dhe përdoruesve është në rritje në kompani.

Kontrollimi dhe barazimi i llogarive të pagueshme dhe të arkëtueshme;

Raportet ditore nga shërbimi i arkës, gjenden e arkës në lidhje me inkasimet ditore, ato të amëvisrisë, bizneseve, gjenden e llogarive bankare, kontinim e tyre, barazimet etj;

Kontrollimi dhe nënshkrimi i kërkesave për blerje, me apo pa kontratë

Kontrollimi dhe nënshkrimi i faturave për blerjet si dhe regjistrimi i tyre në kontabilitet, pas kontrollimeve;

Rifreskimi i shënimeve; të pagueshmet dhe të arkëtueshmet

Kontrollimi i borxheve të konsumatoreve dhe borxhet ndaj furnitorëve, barazimi i furnitorëve si dhe pagesa ndaj tyre.

Përgatitja e raporteve mujore; faturimi, inkasimi dhe shpenzimet; ZRRUK, etj

Takime me kryeshefin lidhur me performancën e majit të kaluar të kompanisë si dhe takime me menaxherët e njësisë.

Raportet ditore me shërbimet brenda departamentit të financave si dhe brenda ndërmarrjes;

Takim me menaxhmentin e kompanisë, me shërbimet përkatëse, etj;

Angazhim i departamentit të financave është në vazhdimësi në kryerjen e detyrave dhe obligimeve të saj, në ofrimin e shërbimeve për sektorët tjerë të kompanisë në mënyrë që të përmirësohet dhe performanca e kompanisë.

## IV. RAPORT I AKTIVITETIT TE PROKURIMIT

### 4.1 Procedurat e prokurimit me vlera të vogla dhe të mesme

Nr Rendor	Titulli I Kontrates	Nr. Prokurimit	Data e nënshkrimit te Kontrates	Qmimi i Kontrates	Emri I OE
1	Hapja e puseve Pizometer si dhe puseve Eksploratuese	HJ/14/014/521	29.07.2014	2,162.00€	NSHN "BURIMI"
2	Hulumtimi i ujit të pijes të krismat e Mushtishtit dhe rezervoari V=1000m3 (Nenprojekti , punimet për sigurimin e	Hj/14/015/521	18.08.2014	73,545.00€	SHPK „Capital Group”



	rezervoarit 2*1000m3 Baqevc)				
3	Furnizim me kepuce(Pune)	HJ/14/016/136	14.07.2014	4,968.00€	Sh.p.k "Solid"
4	Furnizim me pompa zhytесе dhe electromotor per pompa	HJ/14/017/136	18.07.2014	9,795.00€	NTP "LINDA"
18	Furnizim me Uniforma (rrobe pune)	HJ/14/018/136	11.08.2014	9,837.50€	N.P.T "Printeks"
5	Furnizim me material per servisimin e ujmatesave	HJ/14/019/136	11.08.2014	9,236.10	XERXA
6	Furnizim me gaz chlor	HJ/14/020/136	22.08.2014	8,637.00€	"Seykos" sh.p.k
7	Studim, matjet gjeodezike e hartografike dhe vlersimi tekniko financiar per sistemin e ujrave ne zonat rurale	HJ/14/021/221	13.10.2014	44,660.00€	n.p.n"D- Project
8	Furnizim me Tонера	HJ/14/022/136	15.09.2014	9,849.00€	Media Market sh.p.k

## V. RAPORT I AUDITORIT TË BRENDSHËM

Në këtë raport është bërë përmbledhja e aktiviteteve dhe punës së auditorit të brendshëm, për periudhën tremujore korrik – shtator 2014.

Për të gjitha aktivitetet e ndërmarra, ekzistojnë raporte të veçanta të përgatitura me shkrim, të cilat disa prej tyre janë shqyrtuar në takimet me komisionin e auditimit, megjithatë përmes këtij raporti në formë të përgjithësuar, paraqitet një kronologji e punëve dhe aktiviteteve të realizuara për këtë periudhë.

- Në pajtim me planin vjetor të punës për vitin 2014, por edhe me kërkesë të komisionit të auditimit, janë kryer auditime si dhe kontrole në disa subjekte audituese, sikurse në: departamentin e financave, zyren e prokurimit, shërbimin me konsumatorë si dhe në departamentin teknik.

- Fusha e auditimit ka qenë:

- menaxhimi i procesit të prokurimit,
- menaxhimi i procesit të investimeve,
- menaxhimi i procesit të faturimit dhe inkasimit në Njësinë e Prizrenit,
- menaxhimi i procesit të punimit të projektit për ndërtimin e pendës akumuluese në Manastiricë,
- menaxhimi i procesit lidhur me udhëtimin e punonjësve të kompanisë në Shqipëri,
- menaxhimi i procesit të punës në arkën kryesore të kompanisë,
- rishikimi i performancës financiare dhe operative të kompanisë, për vitin 2013, si dhe
- rishikimi dhe adresimi i rekomandimeve të dhëna gjatë periudhës paraprake gjashtë mujore.

- Pas përfundimit të auditimeve, në pajtim me procedurat e punës dhe standardet e auditimit të brendshëm është bërë: përgatitja e drafraporteve, mbajtja e takimeve me subjektet e audituara, diskutimi i të gjeturave dhe rekomandimeve, si dhe finalizimi i tyre (në përjashtim të draftit të auditimit në shërbimin me konsumatorë).

- Duke u bazuar në testimet e kryera dhe të gjeturat e auditimeve, të kësaj periudhe tremujore, është konstatuar se në përgjithësi menaxhimi i proceseve dhe zhvillimi i procedurave në KRU Hidroregjioni Jugor, është kryer në pajtim me dispozitat ligjore, është treguar një performancë e mirë e shërbimeve, si dhe është konstatuar një funksionim i mirë i kontrollit të brendshëm.

- Gjithashtu, gjatë auditimit të disa fushave dhe proceseve, janë konstatuar disa mangësi, që edhe pse nuk janë të ndonjë rreziku të lartë, megjithatë kërkohet të përmirësohen.

Edhe pse rekomandimet e dhëna më gjërësisht janë paraqitur në raportet e audituara, mirëpo sa për ilustrim po paraqes disa nga rekomandimet që janë dhënë në auditimin e procesit të investimeve dhe procesin e faturimit dhe të inkasimit. Rastet kanë të bëjnë me:

- diferencën e konstatuar të shumës së investimeve të realizuara, në mes të të dhënave të raportuara në ZRRUK si dhe atyre ekzistuese në modulën e aseteve.
- rasti i disa inkasantëve, që edhe përkundër se nuk kanë ndonjë diferencë shumë të lartë, megjithatë kanë pasur rënie të faturimit.
- dukurinë e faturimit me vetëm tarifë fikse të një numri të madh të konsumatorëve, etj.

Lidhur me këto konstatime janë dhënë rekomandime konkrete, andaj gjatë muajve në vijim pritet që ato të realizohen në tërësi.



**STRUKTURA ORGANIZATIVE**  
**KRU „HIDROREGJIONI JUGOR” SH.A. PRIZREN**

